



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2083 Prot.

Tiranë, më 21/07 /2025

V E N D I M

(QARKULLUES)

Nr. 49, datë 18.07.2025

PËR

**NJË SHITESË TË VENDIMIT NR. 03, DATË 10.02.2025 “PËR MIRATIMIN E
KRITEREVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE,
PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026, I PËRDITËSUAR”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 25 dhe neni 74, Statutin e Universitetit Politeknik, neni 9, si dhe në propozimin e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, për kriteret e pranimit në programin e ri të ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2025-2026, Senati Akademik me vendim qarkullues të datës 18.07.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e pranimit, për vitin akademik 2025-2026, në programin e ri të ciklit të dytë të studimit, “Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike në Aktuaristikë”, të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Kurrikulave për të shpallur publikisht kriteret e pranimit në faqen zyrtare të UPT dhe në portalin U-Albania.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SENATI AKADEMIK

Kriteret e pranimit në programet e reja të ciklit të dytë të studimit në UPT, për vitin akademik 2025 – 2026.

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 25 dhe neni 74, Statutin e Universitetit Politeknik neni 9, si dhe në propozimet e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike për pranimet në programet e reja të ciklit të dytë të studimit, kriteret e pranimit të ofruara nga ky fakultet i UPT-së, për vitin akademik 2025-2026, janë si më poshtë:

1. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, me programet e studimit:

1. Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike në Aktuaristikë

ka vendosur këto kriteret:

- Lejohen të ndjekin këtë program studimi ata kandidatë që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Matematike dhe Inxhinieri Informatike në UPT, Aktuaristikë, Statistikë, Menaxhim Risku, Inxhinieri Matematike e Informatike, Inxhinieri Matematike dhe Data Science, Matematikë, Informatikë, Shkenca Kompjuterike, Data Science, Financë, Ekonomiks, Informatikë Ekonomike, Inxhinieri Ekonomike, Demografi ose degë të ngjashme me to, në universitete të tjera të vendit ose të huaja.
- Për kandidatë që vijnë nga institucione universitare të afërta, kandidatët duhet të jenë diplomuar në një program të ciklit të parë të licensuar dhe të akredituar. Këto kandidatë mund të plotësojnë kreditet shtesë me një plan vetiak studimi për lëndët ose modulet përkatëse që mungojnë të përcaktuar nga Departamenti i Inxhinierisë Matematike.
- Për kandidatë, të cilët janë diplomuar jashtë vendit duhet të jenë diplomuar në një program të ciklit të parë të licensuar dhe të akredituar. Si dhe duhet të bëjnë njësimin e diplomës në ministrinë përgjegjëse në rast regjistrimi në këtë program studimi.
- Të gjithë aplikantët duhet të njohin një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individ i ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- Kriteri i rëndësishëm pranimi në këtë program studimi është nota mesatare e ponderuar minimale e ciklit të parë të studimeve Bachelor, për t'u pranuar në të. Kjo notë mesatare përcaktohet në çdo vit akademik nga Departamenti i Inxhinierisë Matematike.

Kandidatët fitues do të përcaktohen nga renditja e tyre sipas notës mesatare të ponderuar dhe kuotave të pranimit të përcaktuara për këtë program studimi.

